



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 6, datë 27/04/2021

MBI

**“PROPOZIMIN PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFAVE TË
KONKURRIMIT, TARIFËS SË REGJISTRIMIT, TARIFËS SË SHKOLLIMIT
PROGRAM I PARË STUDIMI SI DHE TARIFËS SË SHKOLLIMIT PROGRAM I
DYTË STUDIMI PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA
NGA FAKULTETET E UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK
2021-2022”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në pikat 28, 29 dhe 30 të nenin 6, të nenit 38 të ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur dhe nga propozimet mbi deklarin e tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe tarifës së shkollimit për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, të ofruara nga e Fakultetet e Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me nr. 23/1 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 115/1 Prot., datë 01.03.2021), Fakultetit të Artit Skenik me nr. 100 prot., datë 24.02.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 136 prot., datë 24.02.2021) dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me nr. 15 prot., datë 01.03.2021 (protokolluar në Rektorat me nr. 144 Prot., datë 02.03.2021), pasi i mori në shqyrtim dhe i diskutoi ato, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Ti propozojë për miratim Bordit të Administrimit tarifat e konkurrimit, tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit (për program të parë studimi dhe program të dytë studimi) për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2021-2022 të ofruara nga Fakultetet e Universitetit të Arteve, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim ti dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Arteve për miratim.
3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

